



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 17 tetor 2017

Numri i lëndës: 2016-26

T.G.

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 17 tetor 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Elka ERMENKOVA, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar në Panel me datën 19 shtator 2016.
2. Ankuesi ka kërkuar që Paneli mos ta bëjë publike identitetin e tij për arsye personale dhe Paneli është pajtuar me këtë kërkesë.

II. FAKTET

3. Faktet e lëndës të paraqitura nga ankuesi mund të përmbliidhen si më poshtë:
4. Ankuesi ka udhëtuar si refugjat në Irlandë, i shoqëruar nga e dashura e tij dhe anëtarët e familjes së saj, në maj të vitit 1999. Ata ishin vendosën atje, ndërsa ai dhe e dashura e tij ishin martuan një javë më vonë.

5. Ankuesi ka gjetur, ku kishte punuar më pak se një vit. Ai ishte larguar nga puna në prill të vitit 2000, në të cilën kohë më vonë u kthye në Kosovë vetë. Gruaja e tij mbeti në Irlandë, ku jeton ende.
6. Gruaja e ankuesit lindi një fëmijë në Irlandë në shkurt të vitit 2000. Ai dyshonte se nuk ishte babai i fëmijës dhe si pasojë martesë e tij dështoi.
7. Parashtruesi i ankesës ka pretenduar se një fëmijë i tij kishte vdekur në një datë të pasaktësuar në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës si pasojë e një injeksioni helmues që i ishte dhënë nga një mjek në Irlandë.
8. Në shkurt 2016, ankuesi ka parashtruar një kërkesë për vizë në Ambasadën Irlandeze në Beograd për të vizituar Irlandën. Kërkesa e tij i ishte refuzuar, me sa duket për shkak se ai kishte paraqitur dokumentacion jo të plotë.
9. Ankuesi i ka shkruar një letër EULEX-it me 2 shkurt 2016, në të cilën ai ishte ankuar për vonesat e dyshuara në lëshimin e vizës nga Ambasada Irlandeze.
10. Shefi i personelit të EULEX-it ishte përgjegjës me 2 mars 2016 dhe e kishte informuar atë se EULEX-i Kosovë zbaton mandatin e sundimit të ligjit kryesisht përmes divizionit ekzekutiv dhe divizionit të përforcimit. Ankuesi më tej ishte informuar se EULEX-i nuk ishte në gjendje të ndërmerre ndonjë veprim lidhur me kërkesën për vizë pasi që çështjet e tilla binin jashtë mandatit të tij. Më tej ai e kishte këshilluar ankuesin që të paraqesë argumentet e tij në Ambasadën e Irlandës dhe i kishte ofruar atij kontaktet e Zyrës për Ndihmë Ligjore Falas në Kosovë.

III. ANKESË

11. Në thelb, ankuesi dëshiron të marrë një vizë për të udhëtuar në Irlandë, ku dëshiron të kërkojë dëmshpërblim ndaj ish punëdhënësi të tij në lidhje me pushimin e tij të padrejtë nga puna dhe të paraqesë një kërkesë për kompensim ndaj mjekut, i cili supozohet se i kishte dhënë një injeksion që ia kishte dëmtuar shëndetin.
12. Duke mos u thirrur në ndonjë dispozitë të veçantë të instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, nga parashtrimet e tij mund të supozohet se ankuesi pretendon në shkëlqje të dispozitave si në vijim: Nenit 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut ("Konventa") (e drejta për gjykim të drejtë), Neni 8 i KEDNj-së (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) dhe Neni 13 i KEDNj-së (e drejta për një zgjidhje efektive).

IV. LIGJI

13. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar të zbatojë instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohet në Konceptin e Përgjegjshmërisë së EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e

Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet juridike demokratike.

14. Para shqyrtimit të ankesës në bazë të meritave të saj, Paneli duhet të vendosë nëse do të pranojë ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullën 29 të rregullores së punës. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, të rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ankesat në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i Kosovë gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv në sektorët e gjyqësisë, policisë dhe doganave.
15. Në rastin në fjalë, Paneli vëren se nuk është argumentuar, e lëre më parë, se EULEX-i ishte në ndonjë mënyrë i përfshirë në shkeljet e supozuara të të drejtave të ankuesit. Ai ka kërkuar ndihmën e EULEX-it në lidhje me refuzimin e një vize për në Irlandë. Në përgjigje, atij iu ishte dhënë një përgjigje e hollësishme mbi afatet dhe kufijtë e mandatit nën të cilin EULEX vepron në Kosovë. Aty ishin sugjeruar gjithashtu hapa të caktuara që ai mund t'i merrte për të adresuar gjendjen e tij. Kjo letër nuk shpalos asnjë vepër që i ngarkohet EULEX-it, që mund të thuhet se përbën shkelje të të drejtave të ankuesit.
16. Për më tepër Paneli gjithashtu thekson që çështjet në lidhje me lëshimin e vizave nga shtetet e treta nuk bien brenda mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë. Rrjedhimisht, kjo ankesë bie jashtë kompetencës së Panelit siç është saktësuar në rregullën 25 të rregullores së punës dhe OPLAN-it të EULEX-it Kosovë (në përgjithësi shih *Shaip Gashi kundër EULEX-it*, 2013-20, 26 nëntor 2013, § 9, *Jovanka, Dragan dhe Milan Vuković kundër EULEX-it*, nr. 2013-18, 7 prill 2014, §§ 11-12).

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë që ta shqyrtoj këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë kompetencave të tij në bazë të nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës dhe prandaj

SHPLL ANKESËN TË PAPANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese